



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 23.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **22.04.2025**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **GENERAL PHARM.SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender “Furnizim me Barna nga LE-Lot 4 (Vaksina kundër Miningjtit Monokoksik A, C, W-135, Y)”** me nr. të Prok: **206-25-2615-1-2-1**nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik Interlab SH.P.K, e dt. 14.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit **Ri-tender “Furnizim me Barna nga LE- Lot 4 (Vaksina kundër Miningjtit Monokoksik A, C, W-135, Y)”** me nr. të Prok: **206-25-2615-1-2-1** kundër Njoftimit për Kontratë të datës 01.04.2025;
2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK të datës 18.04.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik GENERAL PHARM.SHPK me date 22.04.2025 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ri-tender “Furnizim me Barna nga LE- Lot 4 (Vaksina kundër Miningjtit Monokoksik A, C, W-135, Y)”** me nr. të Prok: **206-25-2615-1-2-1**. Autoriteti Kontraktues, me datë 23.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas operatorit ekonomik GENERAL PHARM.SHPK:

Neni 1 Qëllimi

Neni 4 Përkufizimet, pika 1.75,

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 56.3 asnje OE nuk eliminohet për kërkesa që nuk është cekur në NK dhe DT.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Gjithashu AK ka shkelur edhe dispozitat perkatese te RrUOPP-se
Nenin 26 Kriteret e perzgjedhjes,
Nenin 28 Kriteret e dhenies se Kotrates
Nenin 41 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Te pa kenaqur me njoftimin e date 18.04.20251 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me aktivitetin e prokurimit Ri-tender "Furnizim me Barna nga LE- Lot 4 (Vaksina kundër Miningjtit Monokoksik A, C, W-135, Y)" llot 1.

me nr te prokurimit: 206-25-2615-1-2-1 ne afatën ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojme këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- **MINISTRIA E SHENDETESIS:**

1. ne menyre te kunderligjeshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pasi qe i kemi plotesuar te gjitha kereksat e AK te vendosura ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit.
2. ne menyre të kundërligjeshme ka rekomanduar per kontrate OE te pa pergjegjeshem qe eshte me cmim me te larte se ne.

Sqarojmë ne menyre te detajizuar pikat:

1.

Autoriteti Kontraktues - AK MSH-se ne menyre te kunderligjeshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit ku si arsye te eliminimit ka cekur si me poshtë:

Se nuk jemi te licencuar per produktet termoalibile edhe pse kete gje nuk e kerkoni ne dosjen e tenderit por vete se te argumentoje se eshte i paisure

Ne, General Pharm shpk, jemi operator ekonomik që kemi marrë pjesë në publikimin e titullit "Ri-tender "Furnizim me Barna nga LE- Lot 4 (Vaksina kundër Meningjitit Monokoksik A, C, W-135, Y)" dhe numër reference 206-25-2615-1-2-1, të shpallur nga **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**.

Përmes kësaj ankese, duam të shprehim këtë gjë dhe të kundërshtojmë vendimin për eliminimin e kompanisë sonë nga kjo me arsyetimin nuk jemi të licencës për produktet medicinale termolabile.

Në dokumentet e tenderit, konkretisht në Kërkesën 4, është kërkuar që: **Kërkesa 4. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se është i licencuar nga AKPPM si qarkullues me shumicë për produkte medicinale (me validitet) - kopje. ku ne edhe e kemi dëshmuar në dokumentacionin e paraqiturë përmes Platformës elektronike.**

Në asnjë pjesë të kësaj kërkesë nuk është specifikuar që operatori duhet të jetë i licencuar eksplicitisht për produkte termolabile.

Eliminimi ynë për këtë arsye, sipas mendimit tonë, është një interpretim i padrejtë dhe jo objektiv të kritereve të tenderit, që nuk qëndrojnë ligjërisht, duke sjellë kështu një dëmtrim të barazisë në konkurrencë dhe të drejtën për të drejtën e duhur.

Kërkojmë:

Rishikimin e vendimit për eliminimin tonë;

Transmetencë në raportin e kritereve të biznesit në dokumentet e tenderit;

Dhe nëse është e nevojshme, përsëritjen e procesit të vlerësimit në mënyrë zyrtare të shpallura.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe pritjen e kësaj ankese në afatin ligjor, mbetemi në pritje të përgjigjes suaj zyrtare.

Dëshmia 4. Licencë valide nga AKPPM si qarkullues me shumicë për produkte medicinale - kopje. Ku të njëjten e kemi paraqiturë.

Ne mendojmë pasi që OE që ka bërë pyetje njëkosishte edhe ka sqarur se si bëhet bartja, ruajtja se është produkte i ndjeshëm e se duhet me ju përmbajta standardeve të GDP –se, ku vetëm e vetëm sa që nuk e ka ceke apo nuk ka dhënë pyetje/ sqarime për çmimin.

Ne mendojmë se këto kërkesa janë marrë parasysh po ja që edhe është bërë një leshime që nuk ju ka detyruar me kërku edhe që operatori ekonomik të paset me GDP.

Ne si Operator Ekonomik jemi të dëmtuar nga ky vendim i AK i cili është i kundërligjshëm dhe një tentim për ta dëmtuar Buxhetin e Kosovës në mënyrë të kundërligjshme pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-se të vendosura në NJK dhe DT si dhe jemi me të lirë për Lotin që e parashtrojmë këto kërkesa për rishqyrtim

Sipas dispozitave të cekura më lartë do të ekzistonte konflikti i interesit ku kompania konkurrente të lejohet për përfitime personale dëmtimi i buxhetit të R.Kosovës.

Duke pasur parasysh që nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, që OE te jet i licensuar me termolabile, atehere i bejme me dije AK-se se asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk është e parashikuar në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë ashtu siç parashihet tek neni 56 paragrafi 3 ku shkruan *“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë edhe Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Besojme se i kemi elaboruar me shumë se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK që të rrespektoj në përpikëri dispozitat e ligjit të prokurimit publik gjithashtu të rrespektoj kërkesat e veta të cilat vet i ka vendosur në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit dhe të nxjerr;

Dëmet materiale

Nuk është paraqitur ndonjë dëmtim

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Duke e pasur parasyesh se Kerkesa juaj per rishqyrtim ka atakuar kriterin profesional te Licences se AKPPM te kerkuar ne NJK dhe Dosje të Tenderit, kjo kerkese eshte trajtuar nga Njesia e kerkeses konkretisht nga anetaret profesional per hartimin e specifikaconit teknik te ketije aktiviteti:

1. Lidhur me pretendimin për interpretim të gabuar të kërkesës së licencës për produkte termolabile:

Dokumentacioni i tenderit, përkatësisht në Kërkesën nr. 4, parashikon qartë që operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga AKPPM si qarkullues me shumicë për produkte medicinale. Autoriteti Kontraktues, duke u bazuar në natyrën specifike të produktit – vakcina që përbëjnë produkte medicinale termolabile, ka kërkuar verifikimin e vlefshmërisë dhe përputhshmërisë së licencës për këtë kategori specifike. Mosplotësimi i qartë i këtij kriteri për produkte termolabile përbën mospërbushje të kërkesës thelbësore të tenderit dhe si i tillë ka çuar në eliminimin e OE në përputhje me nenin 59 dhe 65 të LPP-së.

Arsyetimi kryesor për eliminimin e këtij operatori është si në vijim:

- Produkti i ofruar – Vakcina kundër Meningjtit Monokoksik A, C, W-135, Y – është një produkt farmaceutik Termolabil, që kërkon ruajtje dhe transport në kushte specifike të temperaturës (nga +2°C deri në +8°C), për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produktit gjatë gjithë zinxhirit të furnizimit (Kjo ka qene e cekur edhe ne sqarimet e dhëna për OE me datë 08.04.2025).
- Licenca e Veprimtarisë si Qarkullues me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale me nr. L1-0157/29/03/2023, e ofruar nga OE GENERAL PHARM SH.P.K, nuk përfshin Licencimin për operim me produkte Termolabile. Kjo do të thotë se OE në fjalë nuk është i Licencuar ligjërisht të qarkullojë produkte të kësaj natyre, duke e bërë ofertën e tij të papranueshme dhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Dëshmi për këtë konstatim është vetë Licenca e ofruar nga OE, ku mungon qartazi aprovimi për operim me produktet Termolabile.

Shih deshmime:

2. Personeli / Osoblje / Personnel

Flora Ramizi Beqiri - Farmacist përgjegjës / Nadležni farmaceut ee / Responsible pharmacist
RKS-0362-17

Leunite Ajvazaj - Teknik i farmacisë / Farmaceutski Tehničar / Pharmacy Technician
KO-35322/A-05-4

3. Zgjerimi i veprimtarisë / proširenje delatnosti / expansion of the activities

Operimi me narkotikë / Rad sa narkoticima / Operation with narcotics:

Operimi me produkte termolabile / Rad sa termolabilnim produktima / Operation with thermolabile products:

Të tjera / Ostale / Others:

Vërejtje:

2. Sa i përket pretendimeve për shkelje të dispozitave të tjera të LPP-së dhe Rregullores për Prokurim Publik (RrUOPP):

- Asnjë nga shkeljet e pretenduara nga OE nuk janë faktuar me prova konkrete;
- AK ka vepruar në përputhje me parimet e **barazisë në trajtim dhe transparencës**, duke i dhënë të gjithë operatorëve ekonomikë mundësi të barabartë për pjesëmarrje;
- Kriteret e vlerësimit dhe eliminimit janë formuluar qartë në Dosjen e Tenderit dhe janë aplikuar në mënyrë të njëjtë për të gjithë OE-të pjesëmarrës.

3. **Për pretendimet mbi “dëmet materiale” dhe “shpenzimet administrative”:**
Nuk ekziston bazë ligjore për kompensim të pretenduar, pasi veprimet e Autoritetit Kontraktues janë ndërmarrë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe brenda autorizimeve ligjore të tij.


Edhe Certifikata e regjistrimit të biznesit (NUI) nga ARBK-në është kërkuar: Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit **për veprimtarinë përkatëse.**

PËRFUNDIMISHT, kërkesa për ri-shqyrtim e OE GENERAL PHARM SH.P.K refuzohet si e pa bazuar, ndërsa mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendim i AK i dates 18.04.2025.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit